

## RREGULLA TEKNIKE PER PRODHIMIN E MATERIALIT SHUMEZUES TE

### ÇERTIFIKUAR PER *FARORET*

- 1. Rregullat e ketij Aneksi zbatohen per çertifikimin e materialit shumezues per speciet frutore te meposhteme dhe nenshartesat e tyre pamvaresisht nese ato jane hibride ose specie te ndryshme botanike.
- ***Ftoi*** (*Cidonia oblonga L.* )
- ***Molla*** (*Malus domestica Borkh and hybrids*)
- ***Dardha*** (*Pirus communis L. dhe hibridet pyrifolia Nak. ose serotina*).
- 2. Repozitori duhet te vendoset prane Institutit te Mbrojtjes se Bimeve Durres (IMB-D).
- 3. Speciet e permendura ne kete Aneks mund te shumezohen me copa, fare ose nepermjet shartimit te bimeve te te njejtes kategori.
- 4. Materiali qe nuk eshte konform kushteve te kerkuara ne kete Aneks do te nxirret jashte procesit te çertifikimit nga Institutet e percaktuara ne nenin 11 te rregullores, te cilat do te informojne DPBMB ne Ministrine e Bujqesise dhe Ushqimit.

## 5.Kontrollet shendetesore kryhen si me poshte

a ) Ne materialin parabaze dhe baze:

- Kontrollet shendetesore duhet te kryhen konform me protokollet per secilen specie siç tregohet ne tabelen 1 dhe 2 te ketij Aneksi.
- Per viruset qe transmetohen mekanikisht, çdo bime duhet te analizohet nje here ne vit; per semundjet qe nuk transmetohen mekanikisht eshte e mjaftueshme analiza e çdo bime nje here ne 5 vjet.
- b ) Ne bimet meme te certifikuara:
- Menyrat e kontrollit jane:
  - - inspektimi vizual: kryhet gjate periudhes kur semundjet gjejne shfaqjen me te larte simptomatologjike.
  - - analizat laboratorike : behen me kerkesen e inspektorit.

## 6. Kontrollet per vertetesine gjenetike kryhen si me poshte:

- a ) Ne materialin parabaze dhe baze:
- Çertifikimi per vertetesine varietore te pemeve frutore mund te leshohet vetem pasi te sigurohet nje lidhje e bollshme e frutave qe ben te mundur vrojtimin e vertetesise fenotipike te materialit.
- Certifikimi per vertetesine varietore te nenshartesave klonale mund te leshohet vetem pas te pakten dy cikleve vjetore ne fidanishte per t'u kontrolluar vertetesia fenotipike.
- Certifikimi per vertetesine varietore te nenshartesave qe vijne nga fara dhe te farave mund te leshohet pas vrojtimit te nje cikli te plote ne fidanishte e se paku 200 filizave per kultivaret qe vijne nga fara.
- Certifikimi per vertetesine varietore duhet te caktohet nga DPBMB ne Ministrine e Bujqesise dhe Ushqimit.

## Vendi dhe menyra e inspektimeve:

- Inspektimet per materialin e marre nga çdo peme e kategorise parabaze dhe baze do te kryhen ne vende te zgjedhura nga DPBMB ne Ministrine e Bujqesise dhe Ushqimit. Gjate dy viteve te para te prodhimit duhet te behen te pakten tre inspektime qe perseriten çdo vit gjate vegjetacionit: ne lulezim; vjelje te *frutave*; renje te gjetheve.
- Vrojtime me te imta ne fenofaza te ndryshme dhe per karakteristikat morfologjike te pemeve do te behen per materialin ne vrojtim.

## b ) Ne bimet meme te certifikuara:

- Vertetesia varietore e bimeve meme te destinuara per prodhimin e materialit te çertifikuar do te kontrollohet ne fazen e nxjerrjes se lastareve dhe /ose lulezim dhe ne renien e gjetheve per dy vitet e para. Kontrollet do te behen gjithashtu ne vjeljen e frutave per nje vit, ne vitin e dyte, te trete ose ne vitin e katert te lulezimit.

## 7. Karakteristikat teknike qe duhet te permbushin Pemetoret meme dhe Fidanishtet me bime te çertifikueshme jane si me poshte:

- a ) Pemetoret meme te kultivareve dhe te nenshartesave duhet te permbushin
- keto kushte:
- - Pemetorja meme duhet te vendoset ne kushte tokesore te mira, ku nuk jane kultivuar peme frutore se paku per tre vjet.
- - Toka duhet te jete e paster nga nematodat vektore te viruseve.
- - Pemetorja meme duhet te vendoset 100 metra larg nga çdo pemtore tjeter kur bimet jane per prodhimin e sytheve.
- - Parcelat brenda pemtores duhet te jene homogjene dhe te identifikohen me lehtesi.
- - Ne parcele rreshtat duhet te dallohen sipas species dhe kultivareve. Kur kultivare te ndryshem vendosen ne te njejtin rresht ato duhet te jene jo me pak se nje meter larg.
- - Parcelat duhet te kene nje zone mbrojtese te pakten 3 metra e cila te jete vazhdimisht e punuar dhe pa asnje lloj vegjetacioni.
- - Blloqet meme per prodhimin e sythave nuk mund te mbahen me teper se 10 vjet.
- - Bimet meme duhet te mbrohen mire nga demtuesit e semundjet e ndryshme.
- - Bimet meme per prodhimin e sythave duhet te rriten pa dhene lule me perjashtim te fazes qe lidhet me inspektimin e vertetesise varietore.

- - Blloqet meme duhet te izoloohen nga rrjedhja e ujrave siperfaqesore, uji per ujitje duhet te jete i paster nga patogjenet dhe vektoret e tyre.
- b) Fidanishtet me bime te çertifikueshme duhet te permbushin kerkesat e meposhtme:
  - - Fidanishtet duhet te vendosen ne toka qe plotesoje kerkesat bujqesore dhe ku nuk jane kultivuar peme frutore per te pakten tre vjet.
  - - Toka duhet te jete e paster nga nematodat vektore dhe nga ato endoparazite.
  - - Fidanishtja duhet te ndahet ne parcela homogjene dhe te identifikueshme qarte per varietete te ndryshme.
  - - Parcela duhet te rrethohet nga nje bord se paku 2 metra i cili duhet te punohet dhe te pastrohet nga çdo lloj vegjetacioni.
  - - Çdo rresht ne parcele duhet te permbaje vetem Pomoide dhe kombinimet e ndryshme te shartimit duhet te vendosen ne distance 1 meter larg.
  - - Fidanishtja duhet te mbrohet mire nga semundjet dhe demtuesit.
  - - Parcela duhet te jete 10 metra larg nga pemetoret e tjera.

## 8. Analizat laboratorike te tokes dhe te bimeve ne blloqet meme dhe ne fidanishte kryhen si me poshte:

- Toka duhet te jete e paster nga *Pratylenchus vulnus* dhe *P. penetrans*.
- Per çdo ha duhet te merren 10 mostra toke me permbajtje rrenjesh, dhe sejcila prej tyre e perftuar nga 5 nenmostra. Mostrat duhet te dergohen menjehere ne laboratorin e IMB Durrës ose ne nje laborator tjeter të njohur zyrtarisht nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit. Nese nematodat e cituara me siper jane te pranishme ne toke atehere blloku duhet te dezinfektohet sipas udhezimit qe jep laboratori. Efektiviteti i trajtimit do te konfirmohet nga analiza nematologjike qe kryhet 6 muaj pas trajtimit.



# PROTOKOLL PER VLERESIMIN E GJENDJES SHENDETESORE TE *MOLLES DHE TE*

## *NENSHARTESAVE QE LIDHEN ME TE PER ÇERTIFIKIMIN "PA VIRUSE*

Emertimi ne anglisht	Shkaktari	Indikatori	Analiza
• <b>1.Viruse (1).</b>			
• Apple chlorotic leaf spot	ACLSV	<i>M.platycarpa</i>	ELIS A
• Apple stem grooving	ASGV	Virginia crab	ELISA
• Apple mosaic	ApMV	GF305	ELISA
• <b>2.MLO.</b>			
• Apple proliferation	MLO	Golden delicious	
• <b>3.Viroids.</b>			
• Apple dapple apple	Viroid	Starkrimson	
• <b>4.Virus-like diseases.</b>			
• Chat fruit		Lord Lambourne	
• Apple rubbery wood		Lord Lambourne	
• Flat limb		Lord Lambourne	
• Apple green crinkle		Golden delicious	
• Rough skin		Golden Delicious	
• Star crack		Golden Delicious	
• Ringspot		Golden delicious	
• Apple stem pitting		Spy 227	
• Spy epinasty		Spy 227	
• Spy decline		Spy 227	
• Bimet indikatore barishtore per transmetim mekanik jane: <i>Chenopodium quinoa Wild, Cucumis satiyus L. cv. Marketer and Nicotiana occidentalis Weeler.</i>			

## PROTOKOLL PER VLERESIMIN E GJENDJES SHENDETESORE TE *DARDHES E FTOIT* DHE

### TE NENSHARTESAVE QE LIDHEN ME TO PER ÇERTIFIKIMIN "PA VIRUSE"

<i>Emertimi ne anglisht</i>	<i>Shkaktari</i>	<i>Indikatori</i>	<i>Analiza</i>
<b>1.Virus (1 ).</b>			
• Apple chlorotic leaf spot	ACLSV	Beurre Hardi	ELISA
• Apple stem grooving	ASGV	Virginia crab	ELISA
<b>2.MLO.</b>			
•			
• Pear decline	MLO	Pyronia veitchii	
<b>3.Virus-like diseases</b>			
• Bark split		Williams	
• Rubbery wood		Lord Lambourne	
• Quince yellow blotch		C 7 -1	
• Stony pit		Pyronia veitchii	
• Stony ring spot		Pyrus A 20	
• Stem pitting		Virginia crab	
• Vein yellowing		Pyronia veitchii	
• 1) Bime indikatore .barishtore per transmetim mekanik jane: <i>Chenopodium qulnoa W11d</i> , <i>Cucumis sativus L. cv. Marketer and Nicotiana occidentalis Weeler.</i>			